**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**

**05 – Nr. _400-18575.**
**Kaçanik, 16.07.2013**

# KORNIZA AFATMESME BUXHETORE E KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITET 2014 – 2016

**K a ç a n i k , Korrik 2013**

# Lista e shkurtesave :

| | |
|---|---|
| AK | Administrata Komunale |
| BE | Bashkësia Evropiane |
| BRK | Buxheti i Republikës së Kosovës |
| BK | Buxheti i Komunës |
| BDMS | Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit |
| BPV | Bruto Produkti Vendor |
| DBK | Departamenti i Buxhetit Komunal |
| DEFZH | Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit |
| DAP | Drejtoria e Administratës së Përgjithshme |
| DAK | Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës |
| DSHMS | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjës Sociale |
| DSHPE | Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës |
| DUKMM | Drejtoria e Urbanizmit, Katastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit |
| DBPZHR | Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| FKBRK | Fondi i Komunave nga Buxheti i Republikës së Kosovës |
| GP | Granti i Përgjithshëm |
| GSA | Granti Specifik i Arsimit |
| GSSH | Granti Specifik i Shëndetësisë |
| THVK | Të Hyrat Vetjake Komunale |
| THV | Të Hyrat Vetjake |
| KASh | Korniza Afatmesme e Shpenzimeve |
| KABK | Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale |
| KG | Komisioni i Granteve |
| KESH | Klasifikimi Ekonomik i Shpenzimeve |
| LFPL | Ligji i Financave të Pushtetit Lokal |
| LMFPP | Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive |
| LVQL | Ligji i Vetëqeverisjes Lokale |
| MF | Ministria e Financave |
| PI | Plani i Integrimeve |
| PIP | Programi për Investime Publike |
| PPP | Partneriteti Privato Publik |
| PVPE | Plani i Veprimit për Partneritet Evropian |
| QBB | Qarkorja e Brendshme Buxhetore |
| RGJB | Rishikimi Gjashtëmujor i Buxhetit |
| ZK | Zyra e Kryetarit |
| ZKK | Zyra e Kuvendit të Komunës |
| ZKF | Zyrtari Kryesor Financiar |

# PJESA E PARË

# 1. SHQYRTIMET HYRËSE

Me procedurat e hartimit të dokumentacioneve përcjellëse të Buxhetit Afatmesëm të Komunës për periudhën e viteve 2014-2016, Komuna zyrtarisht ka filluar qysh nga data 17 maj 2013, atëherë kur nga Ministria e Financave është pranuar Qarkorja buxhetore nr.2014/01 – Për Komunat.

Me këtë Qarkore buxhetore, si zakonisht na janë ofruar udhëzimet e para, pastaj na është përcaktuar kalendari kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar të financimit të komunës për tre vitet e ardhshme 2014-2016.

Në aktivitetet tona gjatë përgatitjës dhe hartimit të draft - Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës (KABK), përveç që jemi bazuar në Qarkoret buxhetore nr.2014/01 dhe 2014/02 – Për Komunat, gjithsesi jemi shërbyer edhe me projeksionet e dhëna me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2014 -2016 në nivel të vendit, si dhe në dokumentin e rëndësishëm strategjik të komunës - draft Planin e Integruar për vitet 2013-2015.
Njëkohësisht, potencojmë se përveç katër (4) dokumenteve të sipërshënuara, në përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunë 2014-2016, jemi bazuar edhe në legjislacionin përkatës nga kjo lëmi si, në Ligjin nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, në Ligji nr. 03/L-048 - Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në Ligjin nr. 03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjin nr.03/L-060– Për Kufijtë Administrativ Komunal.

Gjatë hartimit të Kornizës Afatmesë Buxhetore të komunës 2014 – 2106, gjithnjë kemi pasur për bazë,

- vizionin dhe katër (4) prioritet e nivelit të lartë me Planin e Integruar të komunës për vitet 2013-2015,
- politikat dhe strategjit ekzistuese të komunës sipas dokumentacioneve zhvillimore,
- ndarjet buxhetore mbi bazën e buxhetimit të programeve dhe nënprogrameve buxhetore funksionale të komunës,
- planifikimi i bazuar në mundësitë reale të buxhetit të komunës,
- realizimi i objektivave programore, duke i respektuar në mënyrë strikte procedurat më të avansuara – reformuese nga qeveria e vendit, të cilat janë në pajtueshmëri të plotë edhe me kërkesat dhe rekomandimet e Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN-në),

Vizioni dhe prioritetet e identifikuara me Planin e Integruar të komunës, pastaj instruksionet dhe udhëzimet e marrura nga niveli qëndror, Kufijtë e financimit nga Grantet qeveritare prej Komisionit të Granteve, e në veçanti projeksionet në nivel të vendit e të prezentuara në KASh-in 2014-2016, me të madhe kanë ndihmuar procesit të hartimit të KABK-së 2014-2016, i cili dokument do të jetë bazë për komunën lidhur me procesin e mëtejmë të zhvillimeve buxhetore deri në fazën e aprovimit të Buxhetit të komunës në Kuvend.
Po ashtu, ky draft i miratuar – KABK-ja, do të na shërbejë edhe si dokumentacion ndërlidhëse për realizimin konkret të prioriteteve dhe nënprioriteteve (objektivave) të komunës për tre vitet e ardhshme buxhetore 2014, 2015 dhe 2016.

Në fund, potencojmë edhe këtë të dhënë, se KABK-ja për vitet 2014-2016 dhe të gjitha dokumentacionet e tjera përcjellëse që do të pasojnë, do të jenë një bazë e mirë për Qeverinë komunale dhe për të gjithë bartësit e programeve – nënprogramet buxhetore, për aktivitetet vijuese deri te përmbyllja e të gjitha fazave sipas kalendarit kohor të përcaktuar nga MF-ja.

# 2. KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2014-2016

## 2.1. Deklaratë e Prioriteteve të Qeverisë për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2014 - 2016

Prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2014-2016, janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe institucional të vendit. Prioritetet afatmesme 2014-2016, bazohen në Programin e Punës së Qeverisë 2011-2014, Vizionin dhe Prioritetet për Zhvillim Ekonomik të miratuar në prill të vitit 2011, të bazuar mbi parimet e respektimit të ekonomisë së tregut dhe konkurrencë të lirë. Ky vizion, do të realizohet përmes mekanizmave të tregut, me institucionet e shtetit si ndihmesë për të rregulluar sektorë të caktuar dhe për të garantuar mirëqenien sociale të shtetasve të Kosovës.

Përmbushja e prioriteteve të Qeverisë përfshinë reformat e nevojshme në sektor të caktuar, përmes të cilave do të bëhet plotësimi i parakushteve ekonomike, sociale dhe institucionale në procesin e integrimeve evropiane përkatësisht për përafrimin e Republikës së Kosovës me Bashkim Evropian, NATO-n dhe mekanizmat tjerë relevant ndërkombëtarë. Prioritetet e Qeverisë janë të përmbledhura në katër shtyllat e mëposhtme:

- Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
- Qeverisja e mirë dhe fuqizim i sundimit të ligjit;
- Zhvillimi i resurseve njerëzore;
- Rritja e standardit jetësor dhe mirëqenies sociale për shtetasit e Republikës së Kosovës;

## 2.2. Korniza Makro - Fiskale për vitet 2014 - 2016

Korniza makro-fiskale si bazë e hartimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2014-2016, paraqet mundësitë e përafërta të financimit të shpenzimeve gjatë periudhës së ardhshme afatmesme. Hartimi i Kornizës Fiskale është bërë mbi bazën e parashikimeve makroekonomike gjegjësisht është fokusuar në parashikimin e agregateve kryesor makroekonomik të cilët kanë ndikim në nivel të të hyrave ashtu edhe të shpenzimeve buxhetore. Në kuadër të këtyre agregateve makroekonomik rol kyç ka parashikimi i komponentëve kryesore të BPV-së dhe norma e inflacionit për periudhën e ardhshme afatmesme. Po ashtu, rol të rëndësishëm kanë edhe zhvillimet në bilancin e pagesave gjegjësisht zhvillimet në bilancin tregtar, zhvillime këto të cilat ndikojnë nivelin e të hyrave buxhetore dhe shpenzimeve.
**Duke u bazuar ne zhvillimet e fundit ekonomike në vend si dhe në zhvillimet në ekonominë e euro-zonës rritja ekonomike mesatare për periudhën 2014-2016 është parashikuar të jetë 4.6%.** Parashikimet për periudhën afat-mesme janë bazuar në supozime konservative duke qenë se zhvillimet dhe parashikimet për vendet e euro-zonës nuk japin sinjale të rimëkëmbjes së shpejtë gjë që pritet të vazhdoj të reflektohet edhe ne ekonominë e Kosovës. Sidoqoftë, një rritje e tillë mund të jetë më e lartë, në varësi të përshpejtimit të reformave strukturore dhe përmirësimit të ambientit të jashtëm ekonomik.

Në këtë kontekst, hartimi i një kornize të matur fiskale është parakusht për menaxhim efikas të procesit buxhetor. Kjo për arsye se në kudër të kornizës jepen tavanet e përgjithshme të shpenzimeve gjegjësisht ofrohet kapaciteti fiskal për tre vitet e ardhshme bazuar në parashikimin e të hyrave. Si rrjedhojë në tabelën e mëposhtme është paraqitur një përmbledhje (kumulative) e të hyrave dhe shpenzimeve (përfshirë dhe deficitin) gjatë tre viteve të ardhshme, që paraqet një përafrim të buxhetit për tre vitet e ardhshme.

**Tabela - 1: Korniza fiskale kumulative 2014-2016, në milionë euro**

| Përshkrimi | 2014-2016 |
|---|---|
| **Te hyrat totale** | **4,326** |
| Te hyrat nga tatimet | 3,718 |
| Te hyrat jo-tatimore, THV | 606 |
| **Shpenzimet totale** | **4,776** |
| Rrjedhese | 3,033 |
| Subvencionet dhe transferet | 983 |
| Shpenzimet kapitale | 1,731 |
| **Bilanci i pergjithshem (sipas rregulles fiskale)** | **-357** |
| **Bilanci i pergjithshem (perfshire financimin e njëhershem)** | **-506** |

## 2.3. Të Hyrat dhe Shpenzimet Buxhetore 2014-2016

Për periudhën tre-vjeçare 2014-2016, nga të gjitha burimet buxhetore parashihet të arkëtohen 4.3 miliard euro, apo mesatarisht 1.4 miliard euro në vit. Ky parashikim, që paraqet pikën fillestare në planifikimin e shpenzimeve tre-vjeçare, është konsistent me supozimin se trendi i të hyrave do jetë i ndërlidhur ngushtë me performancën e supozuar makroekonomike, e cila parashihet të lëvizë sipas skenarit bazë të përshkruar në kapitujt e mëhershëm. Po ashtu, në këtë parashikim të hyrash është i përfshirë edhe ndikimi i supozuar kumulativ i kontrollit më të mirë të rrjedhës së mallrave si rezultat i menaxhimit të integruar të kufijve në pikat kufitare veriore. Roli përcaktues i ngushtimit të boshllëkut tatimor pritet të ketë ndikim më të ulët në vjeljen e tatimeve indirekte në krahasim me periudhën tre-vjeçare paraprake; kjo sepse ky përcaktues i trendit të të hyrave tashmë ka pasur kontribut të theksuar në zgjerimin e bazës së tatimeve indirekte. Por, në të njëjtën kohë, pritet që brenda periudhës së parashikimit të vazhdojë kontributi i ngushtimit të boshllëkut tatimor së bazës së tatimeve direkte në trendin e përgjithshëm të të hyrave tatimore. Shkurtimisht, supozimet kryesore ekonomike në të cilat bazohet parashikimi i të hyrave 2014-2016 janë:

- Normat statusore (ligjore) të tatimeve dhe taksave do mbesin të pandryshuara në periudhën afat-mesme 2014-2016
- Rritja reale mesatare e BPV-së në periudhën afat-mesme do jetë rreth 4.5%
- Inflacioni (matur nga IÇK) për periudhën 2014-2016 do jetë 1.6% në mesatare
- Pjesëmarrja mesatare e të hyrave në BPV do të jetë 24%
- Ndryshimet në strukturën e BPV-së pritet të mbeten të kufizuara, me tendencë të rritjes së rolit kontribuues të investimeve dhe eksporteve
- Për të qenë konservativ, ndryshimet favorizuese në ambientin financiar do jenë të kufizuara

Nën supozimin se nuk do të ketë ndryshime të normave statusore të tatimeve, ndryshimi relativ i pjesëmarrjes se kontribuuesve të rritjes reale të BPV-së (me rritje të rolit të investimeve dhe eksporteve, si dhe rritje më të ulët të importeve në krahasim me historikun) pritet të përcillet me një rritje të BPV-së që është më e lartë se rritja e të hyrave buxhetore. Kjo, rrjedhimisht, reflektohet në një pjesëmarrje më të ulët për 1% të të hyrave buxhetore në BPV, krahasuar me mesataren historike prej 25%. Për më shumë, deri në vitin 2016, ky ndryshim pritet të vërehet më shumë tek të hyrat tatimore indirekte që në të kaluarën kanë pësuar ndryshime si rezultat i kontributit të lartë të të rritjes së shpejtë të konsumit në rritjen e përgjithshme ekonomike (shih tabelën 2).

## Tabela 2. Të hyrat tatimore dhe jo-tatimore 2010-2016

| Përshkrimi | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 Buxheti | 2014 Proj. | 2015 Proj. | 2016 Proj. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Te hyrat e përgjithshme | 1,166 | 1,309 | 1,322 | 1,422 | 1,395 | 1,441 | 1,490 |
| Te hyrat tatimore | 894 | 1,058 | 1,094 | 1,181 | 1,197 | 1,237 | 1,283 |
| si % e BPV-së | 21% | 22% | 22% | 22% | 21% | 21% | 20% |
| Te hyrat jo-tatimore dhe të hyrat vetanake | 148 | 163 | 145 | 208 | 197 | 203 | 206 |
| si % e BPV-së | 3% | 3% | 3% | 4% | 4% | 3% | 3% |

*Burimi: MF, Departamenti i Thesarit, Departamenti i Buxhetit dhe Kalkulimet e DPEP*

## Tabela - 3. Shpenzimet totale 2013-2016, në miliona euro

| Pershrimi | 2013 Buxheti | 2014 Proj. | 2015 Proj. | 2016 Proj. |
|---|---|---|---|---|
| *Ne miliona euro* | | | | |
| **Shpenzimet totale** | **1,578** | **1,611** | **1,568** | **1,597** |
| nga te cilat AKP | 8 | 9 | 10 | - |
| **Rrjedhese** | **959** | **1,001** | **1,010** | **1,023** |
| Pagat dhe meditjet | 435 | 447 | 449 | 451 |
| Mallrat dhe sherbimet | 225 | 230 | 234 | 239 |
| *Nga te cilat: komunalite* | *23* | *23* | *23* | *23* |
| Subvencionet dhe transferet | 299 | 324 | 327 | 332 |
| *Transferet sociale* | *268* | *296* | *300* | *306* |
| *Subvencionet per NP* | *31* | *28* | *27* | *26* |
| **Shpenzimet kapitale** | **621** | **606** | **554** | **571** |
| *Nga te cilat: shpenzimet kapitale me financim te njehereshem* | - | **123** | **26** | - |
| **Rezerva** | 4 | 4 | 4 | 4 |
| Kredidhenia | -6 | - | - | - |
| Nga te cilat: kredite per NP | - | - | - | - |
| Nga te cilat: kthimet nga NP | -6 | -6 | -6 | -6 |
| **Bilanci primar** | **-155** | **-215** | **-127** | **-107** |
| Pagesa e interesit | -18 | -19 | -18 | -20 |
| **BIlanci i pergjithshem ( sipas rregulles fiskale)** | **-173** | **-111** | **-119** | **-128** |
| **Bilanci i pergjithshem ( me shpenzimet e njehershme kapitale)** | **-173** | **-234** | **-145** | **-128** |

*Burimi: MF, Thesari dhe parashikimet e departamentit te makroekonomisë*

# 4. MARRËDHËNIET FISKALE NDËRQEVERITARE DHE FINANCIMI KOMUNAL PËR VITIN 2014-2016 BRENDA KORNIZËS AFATMESME TË BUXHETORE ( KAB KOMUNAL)

## Financimi i Komunave 2014-2016

### Financimi komunal agregat për komuna për vitin 2014-2016 (mil. Euro)

**Tabela - 4. Korniza afatmesme e financimit komunal 2011-2016, mil euro**

| **Përshkrimi** | **2011** Aktuale | **2012** Aktuale | **2013** Aktuale | **2014** **Buxheti** | **2015** Parashikimi |
|---|---|---|---|---|---|
| **1. Grantet qeveritare** | **295.90** | **302.44** | **309.92** | **319.52** | **318.41** |
| **Granti i përgjithshëm** | **114.20** | **118.70** | **128.30** | **137.57** | **132.10** |
| Granti i përgjithshëm bazë | | | | **127.80** | |
| Ndikimi nga regjistrimi i popullsisë 2011, sipas nenit 35 të LFPL | | | | **9.77** | |
| **Granti specifik për shëndetësi** | **38.20** | **39.83** | **40.43** | **39.39** | **42.08** |
| **Granti specifik për arsim** | **143.50** | **143.91** | **141.19** | **142.56** | **144.23** |
| Financimi bazë | 142.85 | 139.09 | 140.32 | **142.22** | **144.23** |
| Politikat e reja dhe ne vazhdim: | 0.65 | 4.82 | 0.87 | **0.34** | **0.00** |
| Qendrat e ekselencës | 0.04 | 0.43 | 0.87 | 0.34 | |
| Gjuha angleze | 0.46 | 0.78 | | | |
| Orët e kujdestarisë | | 3.39 | | | 0.00 |
| Pedagogët | 0.15 | 0.22 | | | 0.00 |
| Arsimi joformal | | | | | |
| Kostoja e licencimit | | | | | |
| **2. Grantet për kompetencat e shtuara** | **2.85** | **2.60** | **2.60** | **1.85** | **2.60** |
| Kujdesi shëndetësor dytësor | 2.85 | 2.60 | 2.60 | 1.85 | 2.60 |
| **3.Transferi i Shërbimeve rezidenciale nga MPMS në Skenderaj dhe Graçanicë** | **-** | **0.00** | **0.00** | **0.24** | **0.00** |
| Shërbimet rezidenciale | | | | 0.24 | |
| **4. Të hyrat vetanake komunale** | **51.88** | **60.00** | **63.00** | **67.23** | **69.24** |
| **5. Financimi kontingjent për decent.** | **1.50** | **-** | **-** | **-** | **-** |

## Total financimi komunal për vitin 2014

| Nr | Komuna | Granti i Përgjithshëm: Granti i përgjithshëm (formula bazë) | Kostoja e vitit të parë tranzitor, pas regjistrimit të popullsisë | Total Granti i Përgjithshëm | Granti specifik për Arsim parauniversitar | Granti specifik për Shëndetësi primare | Shëndetësia sekondare | Transferi i Shërbimeve rezidenciale nga MPMS në komuna | Të hyrat vetanake komunale | Total financimi komunal për vitin 2014 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Deçan** | 2.806.480 | | **2.806.480** | **2.313.411** | **885.597** | | | **630.000** | **6.635.487** |
| 2 | **Dragash** | 2.978.536 | | **2.978.536** | **2.280.777** | **752.333** | | | **441.000** | **6.452.646** |
| 3 | **Ferizaj** | 7.154.599 | | **7.154.599** | **9.890.922** | **2.403.475** | | | **3.807.300** | **23.256.296** |
| 4 | **Fushë Kosovë** | 2.479.705 | | **2.479.705** | **2.355.600** | **770.701** | | | **1.729.040** | **7.335.046** |
| 5 | **Gjakovë** | 6.547.428 | | **6.547.428** | **6.939.073** | **2.092.468** | | | **3.045.000** | **18.623.969** |
| 6 | **Gjilan** | 5.994.313 | | **5.994.313** | **8.355.944** | **1.995.585** | | | **3.780.000** | **20.125.842** |
| 7 | **Gllogoc** | 3.905.388 | | **3.905.388** | **4.731.775** | **1.295.256** | | | **1.050.000** | **10.982.419** |
| 8 | **Hani i Elezit** | 772.611 | | **772.611** | **651.052** | **208.083** | | | **242.949** | **1.874.695** |
| 9 | **Istog** | 2.956.691 | | **2.956.691** | **3.018.575** | **869.442** | | | **945.000** | **7.789.708** |
| 10 | **Junik** | 562.350 | 95.969 | **658.319** | **387.085** | **134.635** | | | **89.250** | **1.269.289** |
| 11 | **Kaçanik** | 2.326.160 | | **2.326.160** | **2.519.927** | **739.321** | | | **630.000** | **6.215.408** |
| 12 | **Kamenicë** | 2.698.336 | 297.441 | **2.995.777** | **2.528.669** | **798.540** | | | **934.500** | **7.257.486** |
| 13 | **Klinë** | 2.745.472 | | **2.745.472** | **3.205.167** | **851.894** | | | **840.000** | **7.642.533** |
| 14 | **Leposaviq** | 1.912.310 | | **1.912.310** | **749.444** | **304.788** | | | **17.300** | **2.983.842** |
| 15 | **Lipjan** | 3.996.898 | | **3.996.898** | **4.743.854** | **1.274.764** | | | **1.166.927** | **11.182.444** |
| 16 | **Malishevë** | 3.686.895 | | **3.686.895** | **5.681.675** | **1.208.553** | | | **787.500** | **11.364.623** |
| 17 | **Mamusha** | 731.792 | | **731.792** | **355.950** | **121.867** | | | **63.000** | **1.272.609** |
| 18 | **Mitrovicë** | 4.834.475 | | **4.834.475** | **5.887.212** | **1.591.303** | | | **2.312.436** | **14.625.427** |
| 19 | **Novo Bërdë** | 801.004 | 240.603 | **1.041.607** | **667.211** | **148.909** | | | **185.328** | **2.043.055** |
| 20 | **Obiliq** | 1.585.143 | 985 | **1.586.129** | **1.769.674** | **476.867** | | | **735.000** | **4.567.669** |
| 21 | **Pejë** | 6.731.174 | | **6.731.174** | **7.177.038** | **2.134.381** | | | **3.045.000** | **19.087.594** |
| 22 | **Podujevë** | 6.007.698 | 288.014 | **6.295.712** | **7.228.792** | **1.958.430** | | | **1.417.500** | **16.900.435** |
| 23 | **Prishtinë** | 12.842.237 | 6.978.356 | **19.820.593** | **14.902.874** | **4.401.472** | | | **24.318.250** | **63.443.190** |
| 24 | **Prizren** | 12.542.550 | | **12.542.550** | **12.675.888** | **3.934.188** | | | **6.425.034** | **35.577.659** |
| 25 | **Rahovec** | 3.795.892 | | **3.795.892** | **4.372.573** | **1.243.850** | | | **997.500** | **10.409.814** |
| 26 | **Shtërpcë** | 843.836 | 323.737 | **1.167.573** | **915.529** | **153.777** | **344.544** | | **304.500** | **2.885.923** |
| 27 | **Shtime** | 1.930.206 | | **1.930.206** | **2.415.886** | **604.664** | | | **409.500** | **5.360.257** |
| 28 | **Skenderaj** | 3.505.927 | | **3.505.927** | **4.931.416** | **1.125.457** | | **133.000** | **599.777** | **10.295.577** |
| 29 | **Suharekë** | 4.054.544 | 244.082 | **4.298.626** | **5.056.738** | **1.321.612** | | | **1.917.102** | **12.594.079** |
| 30 | **Viti** | 3.203.519 | | **3.203.519** | **3.862.532** | **1.039.794** | | | **913.500** | **9.019.345** |
| 31 | **Vushtrri** | 4.676.741 | | **4.676.741** | **5.544.311** | **1.546.181** | | | **1.652.000** | **13.419.233** |
| 32 | **Zubin Potok** | 1.070.987 | 341.742 | **1.412.729** | **375.659** | **146.408** | | | **15.750** | **1.950.546** |
| 33 | **Zveçan** | 993.851 | 335.893 | **1.329.744** | **320.933** | **165.550** | | | **12.400** | **1.828.627** |
| 34 | **Gracanicë** | 1.427.095 | 153.973 | **1.581.068** | **1.372.599** | **236.231** | **801.801** | **110.000** | **1.455.677** | **5.557.376** |
| 35 | **Kllokot** | 353.023 | 149.768 | **502.791** | **232.841** | **56.563** | | | **80.000** | **872.195** |
| 36 | **Mitrovica e Veriut** | 1.419.668 | 145.057 | **1.564.725** | **1.436.764** | **272.767** | **699.000** | | **105.400** | **4.078.656** |
| 37 | **Partesh** | 340.587 | 173.420 | **514.006** | **315.328** | **39.545** | | | **42.000** | **910.880** |
| 38 | **Ranillug** | 583.880 | | **583.880** | **388.629** | **85.552** | | | **84.000** | **1.142.062** |
| | **TOTAL** | **127.800.000** | **9.769.041** | **137.569.041** | **142.559.329** | **39.390.804** | **1.845.345** | **243.000** | **67.226.420** | **388.833.939** |

# PJESA E DYTË

## 1. VIZIONI DHE DEKLARATA E PRIORITETEVE TË KOMUNËS PËR VITET 2014-2016

Korniza Afatmesme e Buxhetit të Komunës për periudhën e viteve 2014-2016, paraqet një dokument ndërlidhës në mes të vizionit dhe prioriteteve të përcaktuara të komunës me parashikimet e projeksioneve të dhëna buxhetore për periudhën vijuese afatmesme.

Komuna në fund të vitit 2012, në bashkëpunim me ekspertët e Fondit për Bashkëpunim Evropian – Projekti i Binjakëzimit për komuna të fuqizuara [1], kanë hartuar bashkarisht draf – Planin e Integruar për vitet 2013-2015, në të cilin dokument përveç përcaktimit të vizionit, janë identifikuar edhe katër (4) prioritet dhe nën prioritetet (objektiva).

Plani i Integruar i komunës si dokument strategjik, është i përfshirë në këtë Kornizë Afatmesme të Buxhetit të komunës për vitet 2014-2016 dhe se roli e rëndësia e tij në hartimin e këtij drafti zhvillimor është thelbësore.

Vizioni dhe deklarata e prioriteteve të komunës mbi bazën e Planit të Integruar, si pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Buxhetit të Komunës për 2014-2016, kanë ndihmuar dukshëm në fokusimin tonë në sferën e planifikimit, duke u sigurua një buxhetim sa më i mirë dhe garancinet që në të ardhmën te kemi një process sa më efikas në menaxhimin dhe operimin me mjete buxhetore për çdo viti fiskal.

Në Planin e Integruar, të gjitha prioritetet e komunës janë të përcaktuara dhe të orientuara në drejtim:

- të sigurimit të një ekonomie të qëndrueshme lokale, në vazhdimin e ndërtimit të infrastrukturës publike,
- në zhvillimin e diversitetit dhe prodhimit bujqësor, si dhe në mbrojtjen e mjedisit,
- në krijimin e komuniteteve të fuqishme dhe aktive,
- në zhvillimin e një administrate më efikase, efektive dhe profesionale.

Për të realizuar këto prioritete, komuna do të vazhdojë të bëjë financimin brenda kornizës buxhetore për tre vitet e ardhshme këto sektorë funksional në nivel të komunës si, në infrastrukturë publike, në bujqësi, në sektorët e arsimit, në shëndetësi dhe mirëqenjës sociale dhe në atë të administratës publike.

Për realizimin e këtyre prioriteteve dhe objektivave janë parashikuar mjete buxhetore dhe se sipas parashikimeve të bëra, kostoja e tyre është e përballueshme sespse në vitet vijuese 2014-2016, buxheti i komunës do të shënon trende të rritjës në raport me vitet paraprake.

Në tre vitet e ardhshme, rëndësi e posaçme ido t'i jepet ndarjeve buxhetore te kategoria e investimeve kapitale, për të cilën kategori ekonomike të shpenzimeve në total do të jetë shuma në lartësi prej 5,236,064 €.

***Më poshtë pasqyrojmë Diagramin e Vizionit dhe Prioritet e komunës për vitet 2014-2016:***

[1] Projekt i menaxhuar nga Zyra e Bashkësisë Evropiane (BE) në Kosovë

**Vizioni:**

" Kaçaniku me nivel të lartë të zhvillimit ekonomik, me industri dhe turizëm të zhvilluar, me ambient dhe komunitet të shëndetshëm, mire e arsimuar dhe me kushtet të mira për punë dhe jetesë."

Arritja e një ekonomie lokale dhe infrastrukturë publike të shkëlqyeshme

- Përmirësimi i rrjetit të transportit lokal
- Themelimi i bizneseve të vogla dhe të mesme të reja dhe hapja e vendeve të reja të punës
- Zonat Ekonomike janë mbushur
- Rrjeti i furnizimit me ujë është përmirësuar

Zhvillimi i diversitetit dhe prodhimit bujqësor & mbrojtja e mjedisit

- Fermat janë më të mëdha, më produktive dhe të shumëllojshme
- Maksimizimi i shfrytëzimit të tokës së punueshme
- Turizmi zhvillohet në mënyrë strategjike

Krijimi i komuniteteve të fuqishme, aktive

- Qasja në kujdesin e ofruar nga stafi profesional në ndërtesa të standardeve të larta
- Zvogëlimi i numrit të atyre që marrin ndihma sociale përmes rritjes së punësimit
- Përmirësimi i vazhdueshëm në ofrimin e edukimit dhe arritshmërisë në provime
- Ofrimi i edukimit që i mundëson nxënësve punësim
- Qendrat kulturore të përmirësuara që ofrojnë ngjarje kulturore cilësore.

Zhvillimi i një administrate më efikase, efektive dhe profesionale

- Rritja e përdorimit të TIK-ut në kuadër të Administratës
- Ndërtesa të modernizuara

## 2. KORNIZA FISKALE KOMUNALE PËR VITET 2014 - 2016

Korniza fiskale komunale apo Korniza e të hyrave komunale përfshinë pjesën e buxhetit komunal nga aspekti i parashikimit të të hyrave të përgjithshme komunale për sigurimin e mjeteve për financimin e shpenzimeve të komunës për periudhën e viteve 2014-2016.

Projeksionet në kornizën fiskale komunale për vitet 2014-2016, janë të bazuara mbi bazën reale të komunës dhe në përputhshmëri të plotë me kufijtë buxhetor me Qarkoren Buxhetore nr.2014/01 – Për Komunat dhe të Qarkorës Buxhetore nr.2014/02 [2] dhe me parashikimet e miratuara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2014-2016, në nivel të vendit.

Bazuar në të dhënat nga Tabela – 5, Total financimi komunal për vitin 2014, komuna do të mbështetet me Grant qeveritar në shumë prej 5,585,408 €, ndërsa nga të hyrat vetjake komunale do kemi një inkasim të parashikuar në shumë prej 630,000 € apo një buxhet në total prej 6,215,408 €.
Sipas projeksioneve të dhëna deri në fund të vitit 2016, buxheti i komunës do të shënoj rritje të vazhdueshme, si nga financimi i Grantit qeveritar, po ashtu edhe nga burimi i realizimit të mjeteve edhe nga të hyrat vetjake komunale.

**Sipas trendeve të projektuara të rritjës për vitet 2014-2016, të hyrat e përgjithshme buxhetore do të shënojnë rritje mesatare sipas shkallës 5,4% në vit ( Granti qeveritar sipas shkallës mesatare 5,6%, ndërsa të hyrat vetjake komunale në shkallë vjetore prej 3,4% ).**

Analizuar financimin sipas llojeve të granteve qeveritare, në periudhën vijuesë 2014-2016, trende të theksuara të rritjës do të shënoj financimi nga **Grant i përgjithshëm** (GP), pasi që nga shuma prej 1,892,018 € sa ishte në vitin buxhetor 2013, në vitin e parë buxhetor 2014 do të kemi në dispozicion shumën prej 2,326,160 € apo një rritje 434,142 € ose për afër 23% (22,9%), që kjo rritje kryesisht rezulton nga zbatimi i regjistrimit të fundit të popullsisë, i realizuar në prill/2011.
**( Shkalla mesatare e rritjës për periudhën 2014-2016, parashikohet prej 10,4% në vit )**

Po ashtu, në saje të aplikimit të kritereve të reja dhe numrit real të popullësisë, trende të rritjës kemi edhe te **Granti Specifik i Shëndetësisë** nga shuma prej 624,407 € sa ishte në vitin 2013, në 739,321 € në vitin 2014 apo një rritje për 114,914 € ose për 18,4%.
**( Shkalla mesatare e rritjës për periudhën 2014-2016, parashikohet prej 9,7% në vit )**

Te Granti Specifik i Arsimit, i cili financim qeveritar ka si kriter kryesor numrin e nxënësëve, në vitin 2014 parashikohet të jetë në shumë prej 2,519,927 € ose një rritje simbolike prej 1,01% apo për vetëm 25,293 € ( në vitin 2013 është në shumë prej 2,494,634 €).
**( Shkalla mesatare e rritjës për periudhën 2014-2016, parashikohet prej 1,0% në vit )**

Ndërsa, **Të hyrat vetjake komunale (THVK)** në vitin pauses 2014, parashikohen të jenë në lartësi prej 630,000 € ose një rritje për 5,0% në raport me vitin 2013 (600,000 €), duke u planifikuar një rrije në masë monetare për 30,000 €. Për vitin e fundit 2016, projeksionet e THVK janë në shumë prej 661,878 € , duke u projektuar një rritje prej 10,3% në krahasim me vitin 2013.
**( Shkalla mesatare e rritjës për periudhën 2014-2016, parashikohet prej 3,4% në vit )**

[2] Qarkorja Buxhetore nr.2014/02 – Për Komunat, është pranuar nga MF-ja më datën 17.07.2013, në të cilën dokument janë përcaktuar kufijtë final buxhetor për financimin e komunave me Grant qeveritar për periudhën afatmesme 2014-2016.

## 2.1. Perspektiva e Politikave Fiskale Komunale

Në hartimin e perspektivës së politikave fiskale komunale jemi bazuar në informatat dhe analizat e KASh-it 2014-2016, në të cilin dokument projeksionet makro-fiskale parashohin një përmirësim të konsiderueshëm në vjeljen e të hyrave vetjake komunale (THVK), në rritjen e efikasitetit të shpenzimeve të parasë publike, në zbatimin e kursimeve buxhetore, etj.

Financimi komunal nga të hyrat vetjake komunale për vitin 2014, të parashikuar në KAB Komunal 2014-2016, bazohet në dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.
Të hyrat vetjake komunale për vitin 2014 dhe projeksionet për vitet 2015-2016, përfshijnë të hyrat e planifikuara nga vet komunat.

Sipas rekomandimeve të Misionit të FMN-së dhe të aprovuara nga Qeveria e vendit, komunat do të kenë fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2014, duke përjashtuar vetëm kategorinë për Paga dhe Mëditje.

**Tabela – 6. Projeksionet e të hyrave vetanake nga Komunat për vitin 2014-2016**

| Projektimi ( mil €) | 2011 Aktual | 2012 Aktual | 2013 Aktual | 2014 Buxheti | 2015 Parashikimi | 2016 Parashikimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Të Hyrat Vetjake të Komunave (THVK)* | 51,88 | 60,00 | 63,00 | 67,23 | 69,24 | 70,63 |

## 2.2. Parashikimi i Të Hyrave Buxhetore Komunale

Me parashikimet e dhëna për vitin 2014 dhe projeksionet indikative për vitet 2015-2016, të hyrat buxhetore komunale në masë monetare do të shënojnë trende të rritje permanente prej vitit në vit, me një dominim të vazhdueshëm të financimit nga Granti qeveritar ( Fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës – Fondi i Komunave).

Me projeksionet e parashikuara edhe në tri vitet vijuese 2014-2016, Granti qeveritar në total të Buxhetit të komunës, do të vazhdoj pa kurrfarë ndryshimesh strukturore duke dominuar me pjesmarrje strukturale me 89,9%, ndërsa Të hyrat Vetjake Komunale ( THVK ) me një pjesmarrje prej vetëm 10,1%.

**Tabela -7. Të hyrat e gjithëmbarshme buxhetore komunale për periudhën e viteve 2013 - 2016**

| | | Grante dhe të hyra vetjake (THVK) – 2013 | Grante dhe të hyra vetjake (THVK) – 2014 | Grante dhe të hyra vetjake (THVK) – 2015 | Grante dhe të hyra vetjake (THVK) – 2016 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | në Euro | në Euro | në Euro | Në Euro |
| | **Burimet e të hyrave** | | | | |
| | Granti i Përgjithshëm | 1,892,018 | 2,326,160 | 2,403,028 | 2,485,258 |
| | Granti Specifik për Arsim | 2,494,634 | 2,519,927 | 2,545,126 | 2,570,325 |
| | Granti Specifik për Shëndetësi | 624,407 | 739,321 | 789,789 | 805,585 |
| | **Gjithsej Grantet** | 5,011,059 | 5,585,408 | 5,737,943 | 5,861,168 |
| | **Vitet aktuale** | 600,000 | 630,000 | 648,900 | 661,878 |
| | **Gjithsej të hyrat vetjake** | 600,000 | 630,000 | 648,900 | 661,878 |
| | | | | | |
| | **GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE** | **5,611,059** | **6,215,408** | **6,386,843** | **6,523,046** |

Duke u bazuar në trendet makro-ekonomike dhe projeksionet e dhëna në nivel të vendit dhe bazës së të dhënave numerike në vlerësimet tona të hershme buxhetore për periudhën 2014-2016, Buxheti i i komunës do të shënoj trende të vazhdueshme të rritjes prej vitit në, ndërsa vetëm në vitin 2014, në raport me buxhetin aktual 2013, do të shënoj rritje në masë monetare për 604,349 € ose një rritje prej 10,8%.

Në vitin 2015 do të kemi një rritje të lehtë prej vetëm 2,1% ose për 171,435 € në raport me vitin paraprak 2014, si dhe në vitin e fundit 2016, përsëri kemi një rritje të njejtë, një rritje e matur prej vetëm 2,1% ose në masë monetare shuma prej 136,203 €, përballë vitit 2015.

**Nëse i shikojmë parashikimet buxhetore për vitet 2014-2016, sipas burimeve të financimit, lirisht mund të konstatohet se edhe në tre vitet e ardhshme pasuese, nuk do të ketë ndryshime strukturore për sa i përketë burimit të mjeteve, nga se edhe mëtej Buxheti i komunës do të ketë varëshmëri të lartë nga Grantet qeveritare dhe se nuk do të ketë asgjë të re në sferën politikave fiskale në vend, çka do të thotë se për sa i përket inkasimit të të hyrave komunale, edhe mëtej do të vazhdohet me politika të njëjta fiskale duke u përqëndruar mbajtja e gjenaratorëve kryesor në nivel qëndror.**

Bazuar në kufijtë fillestar të pranuara nga Komisioni i granteve, e të publikuara në Qarkoren buxhetore të MF-së nr.2014/01- Për Komunat, si dhe në Qarkorën tjetër pasuese buxhetore nr.2014/02, financimi qeveritar nuk do të ketë ndryshime strukturore të theksuara gjatë gjithë periudhës së viteve 2014-2016.

Në vitin e parë buxhetor 2014 sipas këtyre parametrave, do të kemi këtë strukturë buxhetore të sigurimit të mjeteve: pjesëmarrja me **89,9% nga të hyrat nga Granti qeveritar** dhe **10.1% nga Të Hyrat Vetjake Komunale** ( do theksuar se në vitin 2013, ky raport ishte në proporcion 89,3% ndaj 10,7%, në favor të financimit nga Granti qeveritar ).

**Shikuar sipas viteve dhe strukturës së burimeve të mjeteve, në vazhdim prezantojmë këtë pasqyrë tabelare:**

**Tabela - 8. Plani Afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal për vitet 2013-2016**

| Nr. | Përshkrimi | Buxheti Aktual 2013 | Plani 2014 | Vlerësimi 2015 | Vlerësimi 2016 |
|---|---|---|---|---|---|
| a | b | c | d | e | f |
| **1** | **TË HYRAT KOMUNALE TOTALE** | **5,611,059** | **6,215,408** | **6,386,843** | **6,523,046** |
| **1.1** | **TË HYRAT VETJAKE KOMUNALE** | **600,000** | **630,000** | **648,900** | **661,878** |
| **1.1.1** | **Tatimi në pronë** | **240,000** | **253,280** | **256,039** | **257,950** |
| **1.1.2** | **Taksat komunale** | **174,750** | **186,470** | **196,711** | **200,800** |
| | Licencat dhe lejet | 5,250 | 10,000 | 15,000 | 17,000 |
| | Çertifikatat dhe dokumentet zyrtare | 48,000 | 48,000 | 48,000 | 50,000 |
| | Taksat e regj.pajisjeve motorike | 45,000 | 45,000 | 45,000 | 45,000 |
| | Lejet për ndërtesa | 20,000 | 25,000 | 30,000 | 30,000 |
| | Taksat tjera komunale | 56,500 | 58,470 | 58,711 | 58,800 |
| **1.1.3** | **Ngarkesat komunale** | **153,250** | **158,250** | **164,150** | **168,128** |
| | Ngarkesat rregullatore | 17,500 | 20,500 | 26,400 | 30,378 |
| | Të hyrat nga qiraja | 16,000 | 16,000 | 16,000 | 16,000 |
| | Bashkë-pagesat për arsim | 34,750 | 34,750 | 34,750 | 34,750 |
| | Bashkë-pagesat për shëndetësi | 14,000 | 16,000 | 16,000 | 16,000 |
| | Ngarkesat tjera komunale (gjobat) | 71,000 | 71,000 | 71,000 | 71,000 |
| **1.1.4** | **Të hyrat tjera** | **32,000** | **32,000** | **32,000** | **32,000** |
| **1.2** | **TRANSFERET QEVERITARE** | **5,011,059** | **5,585,408** | **5,737,943** | **5,861,168** |
| 1.2.1 | **Granti i Përgjithshëm** | **1,679,049** | **2,326,160** | **2,403,028** | **2,485,258** |
| 1.2.2 | **Granti specifik i Arsimit** | **2,707,603** | **2,519,927** | **2,545,126** | **2,570,325** |
| 1.2.3 | **Granti specifik për Shëndetësi** | **624,407** | **739,321** | **789,789** | **805,585** |

Transferet qeveritare sipas kufijëve fillestar të Komisionit të granteve, për vitin e parë 2014 të buxhetit afatmesëm 2014-2016, do të jetë në lartësi prej 5,585,408 € dhe me këtë pjesmarrje strukturale:

- **Granti i Përgjithshëm me 41,6% ;**
- **Granti Specifik për Arsim, me 45,1% ;** dhe
- **Granti Specifik për Shëndetësi, me 13,2%;**

Të hyrat buxhetore komunale realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores për Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullorës së Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna është e autorizuar dhe ka të drejtë t'i inkasoj.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në Pronë, si gjenerator kryesor i të hyrave vetjake komunale (THVK), e që këtë lloj të hyre komuna pas grumbullimit duhet ekskluzivisht të shpenzoj vetëm për qëllime të realizimit të projekteve kapitale si, në infrastrukturë rrugore, në ujësjellëse, kanalizime dhe investime e

tjera, që thenë ndryshe këto mjete pas inkasimit menjëherë iu rikthehen qytetarëve apo tatimpaguesëve përmes formës së investimeve të destinuara për ngritjen e infrastrukturës komunale dhe mirëqenjës sociale.

**Të hyrat e komunës përbëhen kryesisht nga këto lloje të të hyrave:**

- Tatimi në Pronë,
- Taksat për ushtrim te veprimtarisë së biznesit (me pakon lehtësuese fiskale të miratuar në fillim të vitit 2012, të gjitha bizneset ekzistuese dhe ato fillestare janë të liruar për tre vite 2012-2014 nga kjo lloj takse komunale dhe se këto lehtësira do të vazhdohen edhe deri në vitin 2016 duke i përjashtuar disa biznese nga kjo pako: si bankat komerciale, lokalet e lojrave të fatit, , bastoret, ndërmarrjet publike, etj.)
- Taksat për leje të ndërtimit,
- Taksa për shfrytëzimin e tokës ndërtimore në pronë të komunës,
- Taksa për regjistrimin automjeteve motorike,
- Taksat administrative komunale ( taksa për dokumentacionin lidhur me statusin shoqëror si, çertifikatat e lindjës, martesës, shtetësisë etj.),
- Bashkë-pagesat në arsim,
- Bashkë-pagesat në shëndetësi, dhe
- Të hyra tjera ( gjobat direkte dhe indirekte ).

Përveç të hyrave nga Tatimi në Pronë, kemi edhe taksat tjera komunale të cilat kontribuojnë dukshëm në krijimin e THVK, si taksa për regjistrimin e automjeteve motorike, taksat për shfrytëzimin e tokës ndërtimore në pronë të komunës, taksa për lejet e ndërtimit, etj.

Gjatë planifikimit vijues të të hyrave për periudhën e viteve 2014-2016, është marrë për bazë rënja e dukshme e të hyrave te kategoria e taksave për shfrytëzimin e tokës ndërtimore, për shkak të rënjës së numrit të shfrytëzuesëve të pronës së komunës si dhe aplikimi i masave lehtësuese për lirimin e bizneseve komunale për tre vitet e ardhshme buxhetore 2012-2014, me mundësinë reale të mos aplikimit më të tyre.

Po ashtu, taksa komunale për leje ndërtimi është gjithashtu një kategori mjaft e rëndësishme në krijimin e të hyrave komunale, për të cilën në tre vitet në vazhdim 2014-2016, do të zbatohen ndryshime pozitive ligjore në formën e pagesave ( pagesa e dy lloj taksave: njëra për infrastrukturë komunale dhe tjetra në formë të taksës administrative ).

Me qëllim të rritjes së të hyrave vetjake komunale (THVK-ve) për periudhën e ardhshme buxhetore 2014-2016, komuna duhet gjithësesi të ndryshoj efikasitetin e punës në teren përmes shërbimve të inspeksioneve, mundësisht të plotësoi numrin e inspektorëve (ekzekutuesëve) dhe të shikoj të gjitha mundësit që të krijoj një Zyre të përbashkët qëndrore në nivel të Administratës Komunale, e cila do të ishte shumë funksionale për mbajtjen e evidencave " dy – kahëshe ", në të cilën zyre do të mbaheshin evidenca elektronike të mirëfillta financiare për të gjitha obligimet - ngarkesat dhe të pagesave të realizuara për të gjitha llojet e të hyrave që inkasohenë nga komuna, duke u pajisë edhe me një soutver adekuat (program), për krijimin e bazës së të dhënave më të besueshme.

Duke u bazuar në të dhënat e prezentuara në Tabelën 8 – Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal, THVK për vitin aktual buxhetor 2013 janë të planifikuar në shumë prej 600,000 € , ndërkaq për vitet vijuese 2014-2016, përkatësisht në vitin e parë të planifikimit afatmesëm 2014, parashikohen që

THVK-të të jenë në masë prej 630,000 € ose një rritje e maturë prej 5,0% raport me 2013, pastaj në vitin 2015 në shumë prej 648,900 ose një rritje në raport me vitin 2014 prej 3,0% dhe në vitin e tretë 2016 shuma prej 661,878 €, ose 2,0% një shtim i të hyrave në krahasim me vitin 2015.

Nëse i shikojmë të hyrat sipas llojit, lirshëm mund të konstatohet se në të gjitha vitet buxhetore 2014-2016, sikundër edhe në vitet paraprake, kemi një dominim të bindshëm të të hyrave nga Tatimi në Pronë, i cili lloj i të hyrave komunale paraqet burimin kryesorë në krijimin e THVK të komunës ( shih Tabelën - 8 ).

Mbështetur në të dhënat e pasqyruara në tabelarë dhe nga e gjithë kjo që u potencua, mund të konstatohet se përmbushja e të hyrave të përgjithshme buxhetore komunale për periudhën e ardhshme afatmesme 2014-2016, krahas varshmërisë së mëtejme që do të kemi nga alokimet e Granteve qeveritare, gjithësesi do të jemi të varur edhe nga shkalla e realizimit të të hyrave direkte komunale, e që këto të fundit kanë ndikim edhe në shkallën e ekzekutimit të investimeve kapitale, të cilat do të financohen nga ky burim i të hyrave.

# 3. KORNIZA E SHPENZIMVE BUXHETORE

## 3.1. Shpenzimeve buxhetore sipas programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, në KAB Komunale për 2014-2016, janë të përfshira projeksionet orientuese sipas programeve dhe nënprogrameve buxhetore mbi bazën e ndarjës së re buxhetore në pesë (5) kategori kryesore të shpenzimeve për tre vitet e ardhshme të shpenzimeve të përgjithshme të komunës.

Këto projeksione dhe vlerësime të shpenzimeve buxhetore për vitet 2014-2016, janë të bazuara në politikat dhe prioritet e përcaktuara më parë nga programet buxhetore dhe konsolidimi i tyre në nivel të organizatës buxhetore të komunës.

Nisur nga katër (4) prioritetet tona strategjike për vitet 2014-2016, shpenzimet e përgjithshme operative buxhetore do të përqëndrohen para se gjithash në mbulimin e shpenzimeve nga ushtrimin e kompetencave komunale dhe funksionimin sa më efikas të tre (3) sektorëve publik si, të administratën publike, arsimit dhe shëndetësisë me mirëqenje sociale. Ndërsa, te shpenzimet kapitale bazuar në kërkesat e parashtruara nga programet buxhetore, do të bëhen përpjekjet maksimale në sigurimin e mjeteve buxhetore për vitet 2014-2016, duke u krijua një konsum investiv me një pjesmarrje në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore të komunës prej 25,7% në vitin 2014 dhe në vitin 2016 me një participim prej 28,8% ose një rritje strukturale prej 3,1 poena indeksi.

Në sferën e realizimit të projekteve kapitale 2014-2016, rëndësi e posaçme do t’i kushtohet edhe bashkëpunimit me donatorët për shtimin e masës së mjeteve për investime kapitale, për bashkëfinancim të projekteve investive publike, si dhe realizimin e projkteve kapitale me koncesione dhe partneritet publiko-privat (PPP).

**Tabela – 9. Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive ekonomike dhe programeve / nënprogrameve buxhetore – Viti aktual 2013**

| Kodi Progr. | Kodi Nën-PB | Programet / Nënprogramet | 2013 Paga/Mëditje | Mallra / Shërbime | Komunali | Subvencione | Investime Kapitale | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **160** | | **Zyra e Kryetarit** | **75,265** | **47,045** | **-** | **20,000** | **726,362** | **868,672** |
| **163** | | **Administrata dhe Personeli** | **105,385** | **87,000** | **26,500** | **-** | **20,000** | **238,885** |
| | 16328 | Administrata | 100,610 | 85,000 | 26,500 | - | 20,000 | 232,110 |
| | 16528 | Çështjet gjinore | 4,775 | 2,000 | - | - | - | 6,775 |
| **169** | | **Zyra e Kuvendit** | **84,227** | **9,000** | **-** | **-** | **-** | **93,227** |
| **175** | | **Buxheti dhe Financat** | **62,381** | **9,600** | **-** | **-** | **-** | **71,981** |
| **180** | | **Shërbimet Publike dhe Emergjenca** | **126,008** | **63,200** | **12,007** | **-** | **76,300** | **277,515** |
| | 18028 | Infrastruktura rrugore | 34,468 | 53,200 | 10,007 | - | 76,300 | 173,975 |
| | 18432 | Zjarrfikesit dhe Inspek. | 91,540 | 10,000 | 2,000 | - | - | 103,540 |
| **195** | | **Zyra Komunale për Komunitete** | **4,775** | **1,000** | **-** | **-** | **-** | **5,775** |
| **470** | | **Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** | **54,738** | **10,000** | **-** | **45,000** | **55,000** | **164,738** |
| | 47028 | Bujqësia | 20,650 | 6,000 | - | 45,000 | 55,000 | 126,650 |
| | 47108 | Pylltaria dhe Inspeks. | 34,088 | 4,000 | - | - | - | 38,088 |
| **660** | | **Planifikimi Urban dhe Mjedisi** | **59,621** | **6,000** | **-** | **-** | **120,000** | **185,621** |
| **730** | | **Shëndetësia dhe Mirëqenja Sociale** | **551,920** | **117,623** | **18,950** | **5,000** | **25,500** | **718,993** |
| | 73037 | Administrata | 20,700 | 1,200 | - | - | - | 21,900 |
| | 74700 | Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Primar | 500,034 | 108,423 | 15,950 | - | 19,000 | 643,407 |
| | 75635 | Shërbimet Sociale | 31,186 | 8,000 | 3,000 | 5,000 | 6,500 | 53,686 |
| **920** | | **Arsimi dhe Shkenca** | **2,619,352** | **185,000** | **51,300** | **60,000** | **70,000** | **2,985,652** |
| | 92140 | Administrata | 75,749 | 29,000 | 9,500 | 60,000 | 70,000 | 244,249 |
| | 92750 | Arsimi Parashkollor | 44,567 | 12,000 | 6,300 | - | - | 62,867 |
| | 93810 | Arsimi Fillor | 1,951,684 | 102,000 | 24,500 | - | - | 2,078,184 |
| | 95010 | Arsimi i Mesëm | 547,352 | 42,000 | 11,000 | - | - | 600,352 |
| | | **Gjithsej :** | **3,743,672** | **535,468** | **108,757** | **130,000** | **1,093,162** | **5,611,059** |

**Tabela – 10. Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive ekonomike dhe programeve / nënprogrameve buxhetore – Viti 2014**

| Kodi Progr. | Kodi Nën-PB | Programet / Nënprogramet | 2014 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga/Mëditje | Mallra / Shërbime | Komunali | Subvencione | Investime Kapitale | Gjithsej |
| **160** | | **Zyra e Kryetarit** | **83,663** | **47,045** | | **40,000** | **840,597** | **1,011,305** |
| **163** | | **Administrata dhe Personeli** | **106,642** | **49,500** | **26,500** | | **50,000** | **232,642** |
| | 16328 | Administrata | 101,867 | 46,500 | 26,500 | | 50,000 | 224,867 |
| | 16528 | Çështjet gjinore | 4,775 | 3,000 | | | | 7,775 |
| **169** | | **Zyra e Kuvendit** | **81,239** | **9,000** | | | | **90,239** |
| **175** | | **Buxheti dhe Financat** | **65,069** | **10,600** | | | | **75,669** |
| **180** | | **Shërbimet Publike dhe Emergjenca** | **126,208** | **101,800** | **26,007** | | **190,000** | **444,015** |
| | 18028 | Infrastruktura rrugore | 34,668 | 91,800 | 24,007 | | 190,000 | 340,475 |
| | 18432 | Zjarrfikesit dhe Inspek. | 91,540 | 10,000 | 2,000 | | | 103,540 |
| **195** | | **Zyra Komunale për Komunitete** | **5,946** | **4,000** | | | | **9,946** |
| **470** | | **Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** | **55,862** | **18,500** | | **70,000** | **30,000** | **174,362** |
| | 47028 | Bujqësia | 21,650 | 9,000 | | 70,000 | 30,000 | 130,650 |
| | 47108 | Pylltaria dhe Inspeks. | 34,212 | 9,500 | | | | 43,712 |
| **660** | | **Planifikimi Urban dhe Mjedisi** | **58,297** | **7,000** | | | **245,000** | **310,297** |
| **730** | | **Shëndetësia dhe Mirëqenja Sociale** | **551,940** | **125,537** | **23,950** | **5,000** | **164,000** | **870,427** |
| | 73037 | Administrata | 20,700 | 1,200 | | | | 21,900 |
| | 74700 | Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Primar | 500,034 | 116,337 | 20,950 | | 164,000 | 801,321 |
| | 75635 | Shërbimet Sociale | 31,206 | 8,000 | 3,000 | 5,000 | | 47,206 |
| **920** | | **Arsimi dhe Shkenca** | **2,617,206** | **187,000** | **52,300** | **60,000** | **80,000** | **2,996,506** |
| | 92140 | Administrata | 76,822 | 29,000 | 9,500 | 60,000 | 80,000 | 255,322 |
| | 92750 | Arsimi Parashkollor | 44,726 | 12,000 | 6,300 | | | 63,026 |
| | 93810 | Arsimi Fillor | 1,943,209 | 102,000 | 24,500 | | | 2,069,709 |
| | 95010 | Arsimi i Mesëm | 552,449 | 44,000 | 12,000 | | | 608,449 |
| | | **Gjithsej :** | **3,752,072** | **559,982** | **128,757** | **175,000** | **1,599,597** | **6,215,408** |

**Tabela – 11. Shpenzimet komunale parashikimet afatmesme për periudhën 2015-2016, të shpërndara sipas kategorive ekonomike dhe programeve**

| Programet/ Nënprogramet | 2015 | | | | | | 2016 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Paga/ Mëditje | Mallra/ Shërbime | Komunalitë | Subvencione | Kapitale | **Gjithsej** | Paga/ Mëditje | Mallra/ Shërbime | Komunalitë | Subvencione | Kapitale | **Gjithsej** |
| **Zyra e Kryetarit** | **83,663** | **47,045** | | **40,000** | **1,155,432** | **1,326,140** | **83,663** | **47,045** | | **40,000** | **1,086,335** | **1,257,043** |
| **Administrata dhe Personeli** | **106,642** | **49,500** | **26,500** | | **15,000** | **197,642** | **106,842** | **49,500** | **26,500** | | **20,000** | **202,642** |
| Administrata | 101,867 | 46,500 | 26,500 | | 15,000 | 189,867 | 101,867 | 46,500 | 26,500 | | 20,000 | 194,867 |
| Çështjet gjinore | 4,775 | 3,000 | | | | 7,775 | 4,775 | 3,000 | | | | 7,775 |
| **Zyra e Kuvendit** | **81,239** | **9,000** | | | | **90,239** | **81,239** | **9,000** | | | | **90,239** |
| **Buxheti dhe Financat** | **65,069** | **10,600** | | | | **75,669** | **65,069** | **10,600** | | | | **75,669** |
| **Shërbimet Publike dhe Emergjenca** | **126,208** | **101,800** | **26,007** | | **64,700** | **318,715** | **126,208** | **101,800** | **26,007** | | **200,000** | **454,015** |
| Infrastruktura rrugore | 34,668 | 91,800 | 24,007 | | 64,700 | 215,175 | 34,668 | 91,800 | 24,007 | | 200,000 | 350,475 |
| Zjarrfikesit dhe Inspek. | 91,540 | 10,000 | 2,000 | | | 103,540 | 91,540 | 10,000 | 2,000 | | | 103,540 |
| **Zyra Komunale për Komunitete** | **5,946** | **4,000** | | | | **9,946** | **5,946** | **4,000** | | | | **9,946** |
| **Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** | **55,862** | **18,500** | | **75,000** | **30,000** | **179,362** | **55,862** | **18,500** | | **80,000** | **30,000** | **184,362** |
| Bujqësia | 21,650 | 9,000 | | 75,000 | 30,000 | 135,650 | 21,650 | 9,000 | | 80,000 | 30,000 | 140,650 |
| Pylltaria dhe Inspeks. | 34,212 | 9,500 | | | | 43,712 | 34,212 | 9,500 | | | | 43,712 |
| **Planifikimi Urban dhe Mjedisi** | **58,297** | **7,000** | | | **270,000** | **335,297** | **58,297** | **7,000** | | | **300,000** | **365,297** |
| **Shëndetësia dhe Mirëqenja Sociale** | **551,940** | **125,537** | **23,950** | **5,000** | **120,000** | **826,427** | **551,940** | **125,537** | **23,950** | **5,000** | **100,000** | **806,427** |
| Administrata | 20,700 | 1,200 | | | | 21,900 | 20,700 | 1,200 | | | | 21,900 |
| Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Primar | 500,034 | 116,337 | 20,950 | | 120,000 | 757,321 | 500,034 | 116,337 | 20,950 | | 100,000 | 737,321 |
| Shërbimet Sociale | 31,206 | 8,000 | 3,000 | 5,000 | | 47,206 | 31,206 | 8,000 | 3,000 | 5,000 | | 47,206 |
| **Arsimi dhe Shkenca** | **2,617,206** | **187,000** | **52,300** | **70,900** | **100,000** | **3,027,406** | **2,617,206** | **187,000** | **52,300** | **75,900** | **145,000** | **3,077,406** |
| Administrata | 76,822 | 29,000 | 9,500 | 70,900 | 100,000 | 286,222 | 76,822 | 29,000 | 9,500 | 75,900 | 145,000 | 336,222 |
| Arsimi Parashkollor | 44,726 | 12,000 | 6,300 | | | 63,026 | 44,726 | 12,000 | 6,300 | | | 63,026 |
| Arsimi Fillor | 1,943,209 | 102,000 | 24,500 | | | 2,069,709 | 1,943,209 | 102,000 | 24,500 | | | 2,069,709 |
| Arsimi i Mesëm | 552,449 | 44,000 | 12,000 | | | 608,449 | 552,449 | 44,000 | 12,000 | | | 608,449 |
| **Gjithsej :** | **3,752,072** | **559,982** | **128,757** | **190,900** | **1,755,132** | **6,386,843** | **3,752,072** | **559,982** | **128,757** | **200,900** | **1,881,335** | **6,523,046** |

## 3.2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike 2014-2016

### 3.2.1. Pagat dhe Mëditjet

Sipas projeksioneve në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës për vitet 2014-2016, numri i stafit në nivel të organizatës buxhetore të komunës do të mbetet në nivel të njejtë si në vitin 2013 prej 796 punëtorë.

Për vitin 2014 deri në fund të vitit 2016, nuk parashikohet kurrfarë gritje dhe ndryshime në masën monetare për kategorinë e Pagave dhe mëditjeve dhe do të jenë të pandryshuara në shumë vjetore prej 3,752,072 €.

Ndryshimet do të jenë prezente vetëm nga aspekti strukturor ( pjesmarrja strukturale në nivel të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore ). Kështu për deri sa në vitin 2014 Pagat dhe mëditjet do të kenë pjesmarrje strukturale me 60,4%, në fund të vitit 2016 do të kemi rënje strukturale për 2,9 poena indeksi (57,5%), në favor të rritjës së kategorisë së investimeve kapitale.

Ndërsa, sipas projeksioneve të KASH-it 2014-2016 të Qeverisë, gjatë tre viteve të ardhshme 2014-2016, është parashikuar fillimi i zbatimit të reformës së administratës publike, si rezultat i fillimit të zbatimit të legjislacionit që rezultojnë nga Ligji për Shërbimin Civil për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Administratës Shtetërore. Këto ndryshime kryesisht kanë të bëjë me procesin e klasifikimit te vendeve te punës dhe zbatim të sistemit të ri të pagave dhe gradimeve.

### 3.2.2. Mallra dhe Shërbime dhe Shërbimet e Komunalisë

Te këto dy (2) kategori të shpenzimeve gjatë viteve 2014-2016, nuk pritet të shënohet rritje dhe në vazhdimësi për çdo vit do të jenë në masë monetare të pandryshueshme duke mbetur në nivel të vitit të parë buxhetor 2014 deri në 2016 ( Mallrat dhe Shërbimet në masës monetare prej 559,982 € dhe Shërbimet e Komunalisë në shumë prej 128,757 € ). Konstatohet se këto dy (2) lloje të shpenzimeve do të jenë në vlera të njejta reale për vitet 2014-2016, me mundësin e shpenzimit të tyre racional gjatë çdo viti fiskal.

Me projeksionet e dhëna në këtë pjesë të KABK-së 2014-2016, kërkohet të rishikohen mundësitë e zvoglimit të këtyre shpenzimeve në të gjitha segmentet, duke u aplikuar para se gjithash kursime te të gjitha llojet e shpenzimeve operative dhe gjithnjë duke i vënë këto shpenzimet në proporcion të drejtë me mjetet buxhetore të palnifikuara dhe me ato që janë në dispozicion për t'u shpenzuar.

### 3.2.3. Subvencione dhe Transferet

Subvencionet dhe Transferet gjatë periudhës së projektuar 2014-2016, pritet të shënojnë rritje prej vitit në vit me një mesatare vjetore prej rreth 18,2% ( në vitin 2014 do të jenë në lartësi prej 175,000 €, në vitin 2015 në shumë prej 190,900 € dhe në vitin 2016 në shumë prej 200,900 €,

kështu në vitin e fundit 2016 në raport me vitin bazë 2013 – shuma e planifikuar prej 130,000 €, do të kemi një rritje mbi ½ ose për 54,5% ).

Nga kjo kategori e shpenzimeve buxhetore, mjetet e parashikuara do të destinohen kryesisht për realizimin e të gjitha kërkesave që burojnë nga prioritetet e përcaktuara të komunës si ndarje obligative për realizimin e manifestimeve dhe shënimit të datave historike, për funksionimin e aktiviteteve të rinisë dhe shoqërive e klubeve sportive, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, pastaj në mbështetje financiare në shuma modeste për ndërtimin e shtëpive të familjeve pa kulm mbi kokë etj., si dhe subvencionim e bujqëve / fermerëve, e që për këto të fundit për vitin 2014 janë parashikuar 70,000 € ose një rritje për 55,5% ose për 25,000 € më shumë se sa në vitin 2013, kur i kemi të parashikuara për këtë destinacion shumën prej 45,000 €.

### 3.2.4 . Shpenzimet Kapitale

Si deri më tani, kjo kategori e shpenzimeve edhe gjatë periudhës së projektuar 2014-2016, do të vazhdojë të përfaqësohet si kategori e dytë kryesore në strukturën e shpenzimeve, pas shpenzimeve dominonte të kategorisë së Pagave dhe mëditjeve.

Projektet e Investimeve publike do të bashkërenditën në Listën e projekteve sipas prioriteteve të identifikuara me Planin e Integruar dhe kërkesave reale të pranuara nga komuniteti për ndërtimin e objekteve të infrastrukturës ( rrugë, sisteme të ujësjellësit, kanalizimit etj.), si domosdoshmëri edhe për shtytjen e zhvillimit ekonomik lokal.

Projeksionet me destinacion për realizimin e projekteve publike, reflekton nga nevojat e parashtruara me prioritetet e përcaktuara dhe kërkesat e theksuar që të vazhdohet edhe më tej në përmirësimin e infrastrukturës komunale, në ngritjen cilësore të shërbimeve publike në sektorin e arsimit, të shëndetësi dhe administratë publike etj., në përgjithësi në drejtim të ngritjes së standardit të mirëqenjës sociale të qytetarëve të komunës.

Bazuar në ndarjet e parashikuarea buxhetore 2014-2016, shuma e Investimeve kapitale në vitin 2014 do të jetë në lartësi prej 1,599,597 €, me një pjesmarrje strukturale prej 25,7%, me trende të rritjes prej vitit në vit duke arritur në fund të kësaj periudhe trevjeçare me një pjesmarrje prej 28,8% ose një rritje strukturale për 3,1 poena të indeksit, në raport me vitin 2014.

Do theksuar se në ndarjet buxhetore te kjo kategori kemi të bëjmë vetëm me mjetet nga buxheti komunal (Granti qeveritar dhe THVK), dmth. pa përshirjen e financimeve nga ministritë e linjës dhe donatorët eventual, me të cilat komuna ka partneritet të vazhdueshëm.

# PJESA E TRETË

## 1. Strategjia Zhvillimore - Projektet e Investimeve Publike

Në fazat e deritanishme të zhvillimeve buxhetor për periudhën afatmesme 2014-2016, kryesisht jemi bazuar në vizionin dhe prioritet e Planit të Integruar të komunës, në Planin Zhvillimor Komunal si dhe në dokumente e tjera zhvillimore të hartuara nga komuna.

Në përpilimin e Listës së projekteve kapitale për tre vitet 2014-2016, janë marrë parasysh kryesisht katër (4) prioritet e larta të përcaktuara me Planin e Integruar të komunës për periudhën e viteve 2013-2015, si më poshtë të shënuara:

| | |
|---|---|
| **Prioriteti - 1** | **Arritja e një ekonomie lokale dhe infrastrukturë publike të shkëlqyeshme,** |
| **Prioriteti - 2** | **Zhvillimi i diversitetit dhe prodhimit bujqësor si dhe mbrojtja e mjedisit,** |
| **Prioriteti - 2** | **Zhvillimi i diversitetit dhe prodhimit bujqësor si dhe mbrojtja e mjedisit,** |
| **Prioriteti – 4** | **Zhvillimi i një administrate më efikase, efektive dhe profesionale** |

Sejcili prioritetet në veçanti me nënprioritetet (objektivat) ka rezultate specifike për të cilat komuna do të angazhohet që t'i arrijë gjatë kësaj periudhe afatmesme 2014-2016.

Në tabelën – 12, kemi paraqitur përqindjen e buxhetit të alokuar për vitin buxhetor aktual 2013, në drejtim të arritjes së këtyre rezultateve.

**Tabela - 12. Nënprioritet – ( Analiza e Buxhetit për 2013 )**

| REZULTATET | Buxhetit jo - kapital (në %) | Buxhetit kapital (në %) | Buxheti i përgjithshëm (në %) |
|---|---|---|---|
| **Sigurimi i një ekonomie të shkëlqyeshme lokale dhe infrastrukturës publike** | | | |
| Rrjetet e transportit lokal për automjete dhe për këmbësorë janë përmirësuar dhe janë bërë më të sigurta | **2** | **37** | **9** |
| Biznese të reja të vogla dhe të mesme kanë nisur punën dhe janë krijuar vende pune | **3** | **8** | **4** |
| Zonat ekonomike janë të shfrytëzuara mirë | **1** | **2** | **1** |
| Rrjete të përmirësuara të ujësjellësit dhe kanalizimit | **2** | **8** | **3** |
| **Zhvillimi i diversitetit dhe prodhimtarisë bujqësore dhe mbrojtja e mjedisit** | | | |
| Fermat janë më të mëdha dhe më të shumëllojshme | **1** | **1.5** | **1** |
| Toka bujqësore shfrytëzohet në maksimum | **2** | **11.5** | **4** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Turizmi është i zhvilluar në mënyrë strategjike | **1** | **5** | **2** |
| Mjedisi natyror është i mbrojtur dhe i pasuruar | **1** | **2** | **1** |
| **Krijimi i komuniteteve të fuqishme, aktive** | | | |
| Qasje në kujdes shëndetësor që ofrohet nga personel profesional në objekte të standardit të lartë | **12** | **5** | **10** |
| Ulje e numrit të përfituesve të mirëqenies sociale përmes shtimit të punësimit | **4** | **1** | **3** |
| Përmirësim i vazhdueshëm i ofrimit të shkollimit dhe suksesit në provim | **51** | **7** | **43** |
| Shkollimi i ofruar u përshtatet studentëve për punësim | **2** | **1** | **2** |
| Janë përmirësuar qendrat kulturore dhe sportive si dhe vendet për festime dhe përkujtime | **12** | **6** | **11** |
| **Zhvillimi i një administrate më efikase, efektive dhe profesionale** | | | |
| Përdorim i shtuar i TIK në kuadër të administratës | **2.5** | **3** | **3** |
| Ndërtesa dhe pajisje të modernizuara | **2.5** | **1.5** | **2** |
| Përmirësimi direkt i shërbimeve për qytetarët | **1** | **1.5** | **1** |

Nga të dhënat e prezantuara në Tabelen - 12., vërehet se komuna e ka shpërndarë buxhetin e vet për vitin 2013, në drejtim të arritjes së të gjitha prioriteteve dhe nënprioriteteve.

Në vitin aktual 2013, buxheti është duke u menaxhuar në atë mënyrë që të gjitha prioritet janë duke u financuar në mënyrën më të mirë sipas mundësive të komunës, përkundër burimeve të kufizuara financiare.

Për vitin buxhetor aktual 2013, prioriteteve/nënprioriteteve që iu është ndarë një përqindje më e lartë e buxhetit, janë si në vijim:

- **Te buxhetimi Jo-kapitale**, pasqyrohet me numrin e madh të të punësuarëve në këto fusha kyçe të ofrimit të shërbimeve për qytetarët: si në përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit 51%, qasja në kujdesin shëndetësor 12%,

- **Te buxhetimi Kapital**, pasqyrojnë nevojën për të vazhduar me zhvillimin e rrjetit të transportit për të përmirësuar rritjen ekonomike dhe për të ngritur bujqësinë: në rrjetet e transportit lokal për automjete dhe këmbësorë janë përmirësuar dhe bërë më të sigurta 37%, toka bujqësore shfrytëzohet në maksimum 11.5%, e kështu me radhë.

**Analiza Fillestare e buxhetit për Investime Kapitale 2014-16, sipas Prioriteteve dhe Nënprioritet:**

**Tabela - 13. Prioritetet 2014-2016 - (Analiza e Buxhetit)**

| PRIORITETET | Buxheti për Investime Kapitale 2014-16 (në %) |
|---|---|
| Zhvillimi i një ekonomie lokale & infrastrukturë publike të shkëlqyeshme | 57,8 |
| Zhvillimi i diversitetit dhe prodhimit bujqësor, dhe mbrojtja e mjedisit | 16,3 |
| Krijimi i komuniteteve të fuqishme e aktive | 22,5 |
| Zhvillimi i një administrate më efikase, efektive e profesionale | 3,4 |
| TOTALI : | 100% |

Ndërsa, për sa i përket buxhetit Kapital në Tabelën – 13, analizat tregojnë se mëse 57,8% të mjeteve investive janë të ndara për aktivitetet e destinuara për arritjen e prioritetit për "Zhvillimin e një ekonomie lokale & infrastrukturë publike të shkëlqyeshme". Kjo reflekton shumën e investuar në rrjetin e transportit lokal, në rrjetin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimit dhe në zhvillimin e zonave ekonomike. Zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimit dhe përmirësimi i sigurisë së rrjetit të transportit, është i një rëndësie të veçantë dhe ndarja e buxhetit kapital e pasqyron këtë.

Prioriteti për "Krijimin e komuniteteve të fuqishme e aktive", është adresuar përmes aktiviteteve komunale në arsim, shëndetësi e kulturë. Ndarja Kapitale prej 22,5% tregon zotimin tonë për të mirëmbajtur infrastrukturën në sektorin e Shëndetësisë dhe Arsimit.

Bujqësia gjithashtu është një fushë me rëndësi për komunë dhe për këtë arsye analizat zbulojnë se 16,3% e buxhetit kapital i ndahet "Zhvillimit të diversitetit bujqësor dhe mbrojtjes së mjedisit".

Për t'u ofruar qytetarëve tanë shërbime më efikase të cilat ata i meritojnë, kemi krijuar një prioritet për të "Zhvilluar një administratë më efikase, efektive e profesionale". Për ta bërë këtë, ne jemi zotuar dhe kemi ndarë mjete në një përqindje prej afër 4% ( 3,4%) të buxhetit kapital për të modernizuar pajisjet e përdorura nga stafi administrativ i komunës.

Sejcili prej prioriteteve të komunave, të cilat janë përkufizuar në kuadër të Planit të Integruar Komunal, kanë rezultate specifike të cilat po punohet për t'i arritur.

Në tabelën në vijim kemi paraqitur në (% ) buxhetimin e parashikuar për tre vitet vijuese 2014-2016, i orintuar drejt arritjes së këtyre nënprioritet (objektivave)

**Tabela - 14. Nënprioritet 2104-16 - ( Analiza e Buxhetit )**

| **REZULTATET** | **Investimeve Kapitale 2014 -2016 (në %)** |
|---|---|
| **Zhvillimi i një ekonomie lokale & infrastrukturë publike të shkëlqyeshme** | |
| Rrjetet e transportit lokal për vetura dhe këmbësorë janë përmirësuar dhe më të sigurta | **31,8** |
| Ndërmarrje të reja të vogla e të mesme janë hapur dhe janë krijuar vende pune | **5,9** |
| Zonat ekonomike janë plotësuar mjaft mirë | **3,2** |
| Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë dhe i kanalizimit | **16,9** |
| **Zhvillimi i diversitetit dhe prodhimit bujqësor, dhe mbrojtja e mjedisit** | |
| Fermat janë më të mëdha dhe më të llojllojshme | **0,7** |
| Shfrytëzimi i tokës bujqësore është rritur në maksimum | **6,5** |
| Turizmi është zhvilluar në mënyrë strategjike | **1,2** |
| Mjedisi natyror mbrohet dhe është avancuar | **8,0** |
| **Krijimi i komuniteteve të fuqishme** | |
| Kujdes shëndetësor i qasshëm me staf profesional në ndërtesa të standardeve të larta | **8,6** |
| Reduktimi i numrit të atyre që marrin mirëqenie sociale përmes rritjes së punësimit | **0,2** |
| Përmirësimi i vazhdueshëm i ofrimit të arsimit dhe arritshmërisë së provimeve | **3,5** |
| Ofrimi i arsimit është i përshtatshëm për punësimin e studentëve | **2,3** |
| Qendrat kulturore e sportive si dhe vende për festime e përkujtime janë përmirësuar | **7,7** |
| **Zhvillimi i një administrate më efikase, efektive e profesionale** | |
| Rritja e përdorimit të TIK-ut brenda administratës | **1,4** |
| Modernizimi i ndërtesave dhe pajisjeve | **0,8** |
| Përmirësimi i shërbimeve direkte për publikun | **1,2** |

Në bazë të (%) të prezantuara në Tabelën - 14, kemi këto rezultate në ndarjet e planifikuar :

- Rrjetet e transportit lokal për vetura dhe për këmbësorë janë përmirësuar dhe bërë më të sigurta me 31,8%
- Përmirësimi i rrjetit për furnizim me ujë dhe i atij të kanalizimit 16,9% etj.

Në vazhdim të Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës, për vitet 2014-2016, në Tabelen - 15, pasqyrojmë Listën me projekte, në shumë totale prej 5,,236,064 €,_të cilat projekte kapitale do të rishqyrtohen dhe bashkërenditen sipas prioriteteve dhë nën prioriteteve të rishqyrtuara dhe analizuar më lartë ( shih tabelat 13 dhe 14 ).

Në Listën e projekteve kapitale nuk i kemi të përfshira projektet të cilat do të financohen nga grantet e ministrive të linjës dhe donacionet eventuale të donatorëve të cilat mund të ndodhin gjatë tri vjetëve të ardhshme buxhetor 2014-2016.

# 2. PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE PËR PERIUDHËN E VITEVE 2014 - 2016

## 2.1. Lista e projekteve kapitale 2014-2016
## ( Sipas projeksioneve të bazuara vetëm në mjetet buxhetore të Komunës )

**Tabela - 15.**

| Nr. | Programi (Infrastrukturë, Arsim, Shëndetësi, Mjedis etj.) | Emërtimi i projektit | Lokacioni (vendi ku do të realizohet projekti) | Planifikimi | Vlerësimet | | Financimi Total : 2014 - 2016 ( në € ) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2014 | 2015 | 2016 | |
| **A/.** | | **ADMINISTRATA KOMUNALE** | | **1,355,597** | **1,535,132** | **1,636,335** | **4,527,064** |
| **I.** | | **Zyra e Kryetarit** | | **840,597** | **1,155,432** | **1,086,335** | **3,082,364** |
| 1. | Infrastrukturë | Ndërtimi i Infrastrukturës në Zonat Industriale dhe Komerciale | Zonat e përcaktuara me Vendim të KK-së | 10,000 | 50,000 | 60,000 | 120,000 |
| 2. | Infrastrukturë | Asfaltimi i rrugës prej “A.Bajrami deri te Guri Shpum” | Kaçanik | 5,000 | 50,000 | 50,000 | 105,000 |
| 3. | Infrastrukturë | Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës nga Magjistralja deri në Sepetinë | Dubravë | 50,000 | - | - | 50,000 |
| 4. | Infrastrukturë | Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugëve të fshatit Biçec dhe fshatit Nikaj | Biçec-Nikaj | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 150,000 |
| 5. | Infrastrukturë | Asfaltimi i rrugës së fshatit Sllatinë | Sllatinë | 50,000 | 50,000 | 60,000 | 160,000 |
| 6. | Infrastrukturë | Asfaltimi i rrugës së fshatit Gjurgjedell | Gjurgjedell | 5,000 | 50,000 | 50,000 | 105,000 |
| 7. | Infrastrukturë | Asfaltimi i rrugës së fshatit Semajë | Semajë | 50,000 | 70,000 | - | 120,000 |
| 8. | Infrastrukturë | Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës së fshatrave Llanishtë – Nikoc – Kërbliq | Llanishtë – Nikoc – Kërbliq | 25,000 | 50,000 | 50,000 | 125,000 |
| 9. | Infrastrukturë | Asfaltimi i rrugës në Lagjet Përzhaj, Reç,Brat dhe Topojan, në Kaçanik Vjetër | Kaçanik i Vjetër | - | 50,000 | 50,000 | 100,000 |
| 10. | Infrastrukturë | Asfaltimi I rrugës në lagjet Mezraja dhe Tron,në fshatin Kovaçec | Kovaçec | 40,000 | 40,000 | - | 80,000 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11. | Infrastrukturë | Asfalaltimi i rrugës në Lagjen e Burrnikëve,në fshatin Runjevë | Runjevë | 40,000 | 50,000 | - | 90,000 |
| 12. | Infrastrukturë | Asfaltimi i rrugës në fshatin Gërlicë - Prushaj | Gërlicë - Prushaj | 40,000 | 50,000 | - | 90,000 |
| 13. | Infrastrukturë | Asfaltimi i rrugës në Lagjet Rexhepi dhe Fazliu në fshatin Bajnicë | Bajnicë | 5,000 | 30,000 | 20,000 | 55,000 |
| 14. | Infrastrukturë | Asfaltimi I rrugës në fshatinë Begracë | Begracë | 50,000 | - | - | 50,000 |
| 15. | Infrastrukturë | Asfaltimi I rrugëve të Lagjeve Mem dhe Bafti | Dubravë | 30,000 | - | - | 30,000 |
| 16. | Infrastrukturë | Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Lagjen "Ramadan Agushi" | Kaçanik | 15,000 | - | - | 15,000 |
| 17. | Infrastrukturë | Ndërtimi i rrugëve në fshatinë Stagovë | Stagovë | 30,000 | - | - | 30,000 |
| 18. | Infrastrukturë | Ndërtimi i rrugës në Lagjen Selman,në Doganaj | Dogonaj | 20,000 | - | - | 20,000 |
| 19. | Infrastrukturë | Ndërtimi i Urës për këmbësor mbi lumin Lepenc te Lagjeja e Dolloshëve | Soponicë | 5,000 | 50,000 | 50,000 | 105,000 |
| 20. | Infrastrukturë | Ndërtimi i trotuarit në dy krahët prej QPS-së deri te SHF"E.Duraku" në Kaçanik | Kaçanik | 30,000 | - | - | 30,000 |
| 21. | Infrastrukturë | Ndërtimi i kanalizimit për Bajnicë, Doganaj, Elezaj, Duraj, Gabrricë, Koxhaj, Prushaj dhe Gërlicë | Doganaj dhe fshtrat tjera | 5,000 | 20,000 | 20,000 | 45,000 |
| 22. | Infrastrukturë | Rregullimi i rrjetit të ujësjellsit në fshatin Dubravë, Nikë, Rekë, Doganaj, Elezaj dhe Koxhaj | Doganaj dhe fshtrat tjera | 20,000 | 50,000 | 50,000 | 120,000 |
| 23. | Infrastrukturë | Shtimi i kapacit.ujësjellsit nga burimi deri te rezervoari në Kaçanik - Faza I-rë | Kaçanik | 5,000 | 100,000 | 140,000 | 245,000 |
| 24. | Infrastrukturë | Vazhdimi i punimeve në ndërtimi dhe rregull.shtratit të lumit Neredime | Kaçanik | 5,000 | - | - | 5,000 |
| 25. | Infrastrukturë | Vazhdimi i punimeve në ndërtimin dhe rregullimin e shtratit të lumit Lepenc | Kaçanik | 5,000 | 50,000 | 60,000 | 115,000 |
| 26. | Infrastrukturë | Ndërtimi i Vorrezave të Dëshmorëve | Kaçanik | 30,000 | 50,000 | 50,000 | 130,000 |
| 27. | Infrastrukturë | Rregullimi i lokacionit për vorrezat e qytetit | Kaçanik | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 150,000 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 28. | Infrastrukturë, Mjedis, Arsim, Kulturë, etj. | Mjetet për bashkëfinancim të projekteve | Kaçanik | 170,597 | 195,432 | 236,335 | 602,364 |
| 29. | Furnizime | Furnizimi me automjete zyrtare | Administrata Komunale, Arsimi dhe Shëndetësia | - | - | 40,000 | 40,000 |
| **II.** | | **Administrata e Përgjithshme** | | **50,000** | **15,000** | **20,000** | **85,000** |
| 30. | Institucione / Objekte / Publike | Renovimi i zyreve në objektet e Administratës Publike | Kaçanik | 35,000 | 10,000 | 10,000 | 55,000 |
